

REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA E KUNDËR KORRUPSIONIT ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Nr. Prot. B. Prot. Prot. No.	03-4113/12
Nr. Dat. Dat. Prot.	12.11.2012
Nr. pagës	02

GJL nr.1107/2012

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve: Ragip Namani kryetar, Dalip Bega dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. juridike Ganimete Dumani, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Agjencioni Kundër Korrupsion, kundër aktvendimit të Gjykatës komunale për kundërvajtje në Dragash, Regj.I.nr.637/2012, të dt. 16.08.2012 e në bazë të neneve 31 al.3, 39 dhe 222 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me 25.10.2012, nxjerr:

A K T V E N D I M

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

ABROGOHET aktvendimi i Gjykatës komunale për kundërvajtje në Dragash, Regj.I.nr.637/2012, i dt 16.08.2012, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës dhe rivendosje.

Nga një kopje e këtij aktvendimi u dorëzohet palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Dragash, me aktvendimin Regj.I.nr.637/2012, të dt.16.08.2012 të pandehurin Shehadin Tërshnjaku, nga fsh. Pllavë K Dragash, e ka shpallë përgjegjës sepse si zyrtar i lartë publik, në afatin e përcaktuar ligjor, gjegjësisht deri më 31 Mars 2012, nuk e ka plotësuar dhe dorëzuar formularin për deklarimin e pasurisë Agjencionit Kundër Korrupsion, me ç, veprim ka bërë kundërvajtje nga neni 17 pika 1/3 të Ligjit nr. 04/L-050, në bazë të kësaj dispozite konform nenit 10 të LK-së i ka shqiptuar dënimin me QORTIM.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur Agjencioni Kundër Korrupsion për shkak të: vendimit mbi dënim, në arsyetim të ankesës pos tjerash thekson se gjykata e shkallës së parë ka marr aktvendim dhe i ka shqiptuar qortim të pandehurit duke aplikuar nenin 10 të Ligjit mbi kundërvajtjet përkundër përgjegjësisë lartë të të pandehurit për obligimin e deklarimit të pasurisë, se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar në pajtim me ligjin nr. 04/L-050, dhe me shqiptimin e qortimit ka rënë në kundërshtim me rregullat dhe zbutjen e dënimit të përcaktuar me nenin 9 të LK-së etj. andaj propozon që aktvendimi i atakuar të abrogohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur, por duke u bazuar edhe në shkresat tjera të lëndës, ankesën e paraqitur nga Agjencioni Kundër Korrupsionit në Prishtinë e aprovoi si të bazuar, kurse aktvendimi i goditur abrogohet dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji vendosi për abrogimin e aktvendimit të atakuar për shkak të shkeljes të dispozitave procedurale kundërvajtëse dhe për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike. Shkeljet procedurale kanë të bëjnë me mosmarrjen në pyetje të të pandehurit para se të merret aktvendimi. Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit të ankmuar bazohet në një “deklaratë të dhënë me shkrim” nga i pandehuri ku gjoja ai nuk

2.

ka qenë i njoftuar dhe nuk e ka pasur në dispozicion formularin për deklarimin e pasurisë dhe për këtë çështje është njoftuar vetëm në gjykatë për kundërvajtje, (por në shkresat e lëndës nuk ka kurrfarë deklarate me shkrim të pandehurit) dhe nuk ka dëshmi se është marrë në pyetje në cilësinë e të pandehurit, andaj për këtë arsye në këtë lëndë edhe gjendja faktike mbetet e pa vërtetuar, dhe gjykata pa administruar prova tjera e ka shpallur përgjegjësinë të pandehurit dhe i ka shqiptuar qortim.

Në plotësim procedure gjykata e shkallës së parë, duhet të veprojë sipas vërejtjeve të theksuara më lartë, të merr në pyetje të pandehurin eventualisht edhe ushtruesin e kërkesës, të administrojë edhe prova tjera eventuale dhe më në fund varësisht nga vërtetimi i gjendjes faktike të merr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në Ligj.

Nga të lartcekurat konform të nenit 222 të LMK u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË,
GJLnr.1107/2012, dt. 25.10.2012.

SEK. JURIDIKE
Ganimeta Dumani



KRYETARI I KOLEGJIT

Ragip Namani

